



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.02.2025, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 03.02.2025.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për shoqëritë Ujësjellës Kanalizime për vitin 2025.
3. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin janar 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
4. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2024.
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 302, datë 30.12.2024, “Mbi shqyrtimin e propozimit të FTL sh.a. për draft marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet Furnizuesit të Tregut të Lirë sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë”.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 263, datë 02.12.2024.